

VENDIM
Nr. 642, datë 29.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 129, DATË 22.2.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 129, datë 22.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, shifra “34 188.8 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetë)” zëvendësohet me “31 791.8 (tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një pikë tetë)”, shifra “167 869 732 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy)” zëvendësohet me “149 874 122 (njëqind e dyzet e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e dy)” dhe shifra “181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë)” zëvendësohet me “163 839 908 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetë)”.

b) Në pikën 5, shifra “181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë)” zëvendësohet me “163 839 908 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetë)”.

c) Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime:

i. Numrat rendorë 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 36 hiqen;

ii. Te rreshti “TOTALI”, shifra “34 188.8 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetë)” zëvendësohet me “31 791.8 (tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një pikë tetë)”, shifra “167 869 732 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy)” zëvendësohet me “149 874 122 (njëqind e dyzet e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e dy)” dhe shifra “181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë)” zëvendësohet me “163 839 908 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetë)”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale 1, dhe Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Jug, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe